



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, shkronja b, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 04/L-174, korrik 2013), nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja b, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PARCELËS 494-4**  
**NË KUADËR TË PLANIT RREGULLUES URBAN "PRISHTINA E RE -**  
**PERËNDIM"**

**Neni 1**  
**Lloji i dokumentit**

Miratohet Vendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, ZK Çagllavicë, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim", në Prishtinë.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Ndryshimi i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ka të bëjë me ndryshimin e destinimit të planifikuar të parcelës nr. 494-4, ZK Çagllavicë, në kuadër të Planit rregullues "Prishtina e Re - Perëndim", gjegjësisht parcela e lartcekur destinohet për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.

**Neni 3**  
**Organet për zbatim**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Organet e tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Vendimi nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

**Neni 4**  
**Përmbajtja**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tekstuale dhe grafike e ndryshimit të destinimit të parcelës nr. 494-4, ZK Çagllavicë.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01. nr. 350/05-0182484/17, më 26.07.2017.



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**